




**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

|               |            |            |          |
|---------------|------------|------------|----------|
| Dep.          | Nr. i faq. | Data       | Prot No  |
| Dep.          | Nr. i faq. | Data       | Prot No  |
| 2-D/DPK       | 02         | 09.01.2015 | 01-34/15 |
| Broj stranica |            | Datum      |          |
| Nr. pages     |            | Date       |          |
| PRISHTINE     |            |            |          |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.01.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-4696-14 për z.Xhevdet Thaqi – U.D.Prorektor i Universitetit publik të Gjilanit, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4696-14, për Zyrtarin e lartë, z.Xhevdet Thaqi–U.D.Prorektor i Universitetit publik te Gjilanit dhe njëkohësisht person i autorizuar në një ndërrmarrje private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z.Thaqi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Thaqi është deklaruar se shumë shpejt do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme.

Ndërkohë, z.Thaqi, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë "Informata mbi biznesin" (DPK-03-5058/14) nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i të qenurit person i autorizuar i biznesit "GOLDEN - B" Sh.p.k, duke emruar në këtë funksion një person të besuar.

Tani, z.Thaqi, ushtron vetëm funksionin e tij publik; U.D. i Prorektorit të Universitetit publik të Gjilanit.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit  
Hasan Preteni



*[Handwritten signature over the stamp]*